



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine, datë: 21.03.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit Ministrise se Shendetsise, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit per Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Rregulloren për Prokurimin publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkeses për ri-shqyrtim** të datës 18.03.2024 të parashtruar nga Operatori Ekonomik me shifren **3005**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull **“Konkurs projektimi për Nderimin e QKMF Shtime”** me nr prokurimi 206-23-5282-2-2-3, **nxjerr:**

V E N D I M

1. **Refuzohen**, si te jashtafatshme kërkesat për rishqyrtim e OE me shifren **3005** e datës 18.03.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Konkurs projektimi për Nderimin e QKMF Shtime”** me nr prokurimi 206-23-5282-2-2-3, kundër NJOFTIMIT PËR REZULTATET E KONKURSIT TË PROJEKTIMIT - REZULTATET E VLERËSIMIT ARTISTIK të datës 11.03.2024, te publikuar ne platformën elektronike.
2. **Vërtetohet** NJOFTIMI PËR REZULTATET E KONKURSIT TË PROJEKTIMIT i datës 11.03.2024;
3. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatorët Ekonomik me shifren **3005** me datën 18.03.2024 ne ora 18:23 ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Konkurs projektimi për Nderimin e QKMF Shtime”** me nr prokurimi 206-23-5282-2-2-3. Autoriteti Kontraktues, sot me datë 21.03.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pergjigjia e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimet Ankimore te OE ankues:

Baza Ligjore për refuzim të Kërkesës për Ri-shqyrtim

Ligji i Prokurimit Publik në bazë të nenit 108/A – Zgjidhja e mosmarrëveshjeve, para 3. i cili thekson:

3. *Kërkesa për shqyrtim duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme:*

1.2 *në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit që i është dërguar ankuesit.*

Njoftimi mbi rezultatet e konkursit të projektimit është bere me daten 11.03.2024.

Afati per ankesa ka qene si ne vijim: dita e pare – 12 mars; dita e dyte – 13 mars; dita e tete – 14 mars; dita e katert – 15 mars; dita e peste – 16 mars (e shtune) e cila per shkak te vikendit perfshihet edhe dita e hene 18 mars, si dita e fundit deri ne ora 16:00.

Ju keni dorezuar Kerkesen per rishqyrtim me date 18.03.2024 ne ora 18:23, ose 2.23 ore pas afatit kohor.

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 108/a par.3 dhe 3.2. OE ankimor ka lëshuar afatin ligjor (ius strictum) për të parashtruar ankesë pasi që ka parashtruar ankesë pas afatit te fundit per dorezim te ofertave.

Nenin 60.1(b) i Rregullave te prokurimit pubik

Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së publikimit të njoftimit mbi vendimin e AK (B58) ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit në sistem të prokurimit elektronik. Në kalkulim të afateve kohore, dita e publikimit të Njoftimit mbi vendimit të AK (B58) është dita (0)

Nenin 63.2 i Rregullave te prokurimit pubik

Vendimi mbi refuzimin ose miratimin është obligativ dhe do të publikohet në sistem të prokurimit elektronik nga Zyrtari Përgjegjës i prokurimit. Në rastet kur zyrtari përgjegjës i prokurimit nuk nxjerrë vendim në lidhje me kërkesën për shqyrtim dhe nuk njofton operatorin ekonomik për afat shtesë, Operatori Ekonomik ka të drejte që të parashtroj një ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit pas skadimit të afatit prej 3 (tre) dite pune nga data e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim. Në kalkulim të afateve kohore data e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim është dita (0).

AK hedh poshte ankesen e parashtrua ne perrputhje me nenin 108/a i LPP-se paragrafi 8.1 cili nen percakton se:

Autoriteti kontraktues do ta refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur: 8.1 kërkesa nuk dorëzohet brenda afateve kohore të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni.


Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Vendimi i dorëzohet:

1. OE me shifren 3005
2. Operatoreve ekonomik te interesuar



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit